



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

HAPJA E RRUGËS PËR BIZNES MË TË MIRË NË KOSOVË

CILAT JANË PENGESAT E RRIJTJES SË BIZNESIT NË KOSOVË?



Prishtinë, 2019



HAPJA E RRUGËS PËR BIZNES MË TË MIRË NË KOSOVË

Cilat janë pengesat e rritjes së biznesit në Kosovë?



Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
1. HYRJE DHE JUSTIFIKIM / ARSYETIM.....	9
2. PENGESAT JASHTË KOMPANISË	12
2.1 DHJETË PENGESAT KRYESORE PËR VEPRIMTARI BIZNESORE NË KOSOVË	14
2.1.1 PËRMBLEDHJE E PENGESAVE PËR BIZNESET: MJEDISI EKONOMIK.....	16
2.1.2 PËRMBLEDHJE E PENGESAVE PËR KUSHTET ADMINISTRATIVE DHE RREGULLATORE.....	19
2.1.3 PËRMBLEDHJA E PENGESAVE TË INFRASTRUKTURËS DHE KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME	22
2.2 PENGESAT SIPAS SEKTORIT	25
2.3 PENGESAT SIPAS MADHËSISË SË KOMPANISË.....	27
2.4 PENGESAT SIPAS RAJONEVE	29
3. PENGESAT E BRENDSHME.....	31
3.1 FAKTORËT E BRENDSHËM SIPAS SEKTOREVE	34
4. TENDENCAT E KOMPANIVE	35
4.1 PRITJET E BIZNESEVE PËR ZHVILLIMIN E INVESTIMEVE NË VITIN 2019	42
4.2 INFORMALITETI.....	46
5. BARRIERAT E PËRGJITHSHME DHE SFIDAT.....	60
6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	65
7. METODOLOGJIA	68
8. REFERENCA.....	69



Të nderuar,

Oda Ekonomike e Kosovës është gjithmonë e përkushtuar të fuqizojë rolin e sektorit privat në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Për ta mundësuar këtë, krahas shërbimeve që ofron, në vazhdimësi informon komunitetin e biznesit lidhur me zhvillimet ekonomike në vend, dhe adreson çështjet me rëndësi tek institucionet relevante.



Ndër iniciativat kryesore në mbështjete të sektorit privat është identifikimi i barrierave që hasin bizneset gjatë veprimtarisë së tyre biznesore në fusha të ndryshme dhe dhënia e rekomandimeve për të përmirësuar ambientin e të bërit biznes.

Oda Ekonomike e Kosovës, pas hulumtimit me kompani të ndryshme të sektorit privat, përmbledh dhe analizon barrierat kyçe të bizneseve në studimin "*Hapja e rrugës për biznes më të mirë në Kosovë*". Ky studim kërkimor, i pesti më rradhë që nga viti 2014, ka për qëllim identifikimin e pengesave më të mëdha që pengojnë funksionimin normal të kompanive qofshin ato pengesa të natyrës së jashtme si mjedisi ekonomik, kushtet administrative dhe aspekte infrastrukturore apo të brendshme që lidhen më shumë me çështjet menaxheriale dhe operacionale.

Rritja dhe zhvillimi i bizneseve pamundësohet nga një ambient jo i favorshëm i të bërit biznes, prandaj përmes studimeve të tilla Oda Ekonomike e Kosovës synon të japë kontributin e saj duke hapur rrugën drejt adresimit të barrierave të cilat identifikohen.

Shpresoj që të gjithë bashkërisht, përfshirë bizneset, institucionet shtetërore, donatorët dhe akterët tjerë relevant, të ndihmojmë në funksion të krijimit të një ambienti më të mirë për të bërë biznes dhe fuqizimit të sektorit privat si shtyllë e zhvillimit socio-ekonomik në vend.

Sinqerisht,

Berat Rukiqi



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) që nga fillim-viti 2013, në baza të rregullta tremujore publikon studimin mbi klimën e biznesit dhe tendencat ekonomike në vend. Studimi në fjalë ofron informata shumë të dobishme për vendimmarrësit në nivel qeveritar dhe poashtu orientim të ndërmarrësve në kuadër të politikave të brendshme të kompanive.

Oda Ekonomike e Kosovës për të pestin vit me radhë është duke e bërë edhe një studim kërkimorë për të identifikuar pengesat më të mëdha të cilat janë duke penguar funksionimin normal të kompanive. Këto pengesa janë të natyrës së jashtme dhe brendshme. Pengesat e jashtme mund të jenë si në vijim:

- Mjedisi/ ambienti ekonomik,
- Kushtet administrative dhe rregullative, dhe
- Aspekte të natyrës infrastrukturore.

Pengesat e brendshme janë të lidhura me çështje menaxheriale dhe operacionale.

Në vitin 2018 komuniteti i biznesit ka pasur probleme të shumta. Në kuadër të top barrierave këtë vit me përqindje të ngjashme janë *“vështirësitë në qasjen në financa”* dhe *kostoja e lartë e energjisë elektrike*, respektivisht për 49.4% të kompanive për secilën, duke pasuar *furnizimi jo i rregullt me energji (46%)* si top barriera e tretë për këtë vit, duke rikthyer sërish qështjen e energjisë si problemin kryesor me të cilin bizneset përballen.

Në aspektin e barrierave ekonomike, përveç vështirësive në qasjen në financa, bizneset janë përballur edhe me *konkurrencë jo lojale nga ekonomia e hirtë (43%)* dhe me *vonesat në pagesa nga ana e konsumatorëve (26%)*. Për të dytin vit me radhë konkurrenca jo lojale vazhdon të jetë ndër barrierat më të përmendura në këtë kategori.

Dimensioni i barrierave administrative nxjerr në pah vështirësitë që hasin kompanitë si rezultat i mungesës së legjislacionit të përshtatshëm dhe mos harmonizimit të ligjeve me nevojat e bizneseve. Në masë të madhe ky aspekt sipas kompanive ka ndikuar në nivelin e ultë të zhvillimit të tyre, veçanërisht sa i takon përmirësimin të ambientit biznesor dhe stimulimit të rritjes së ndërmarrjeve mikro dhe të vogla.

Nga ana tjetër barrierat e natyrës infrastrukturore përbëjnë një numër goxha me ndikim të barrierave të përgjithshme me të cilat janë përballur bizneset në vend. Përveç kostos së energjisë elektrike (49%) dhe furnizimit jo të rregullt dhe jo stabil me energji (46%), *jo-stabiliteti politik (25%)* paraqet barrierën më të madhe në këtë dimension, pasur nga *krimi, vandalizimi dhe vjedhja (18%)* që si fenomen janë rritur konsiderueshëm në vitin 2018.

Në kuadër të vështirësive të brendshme, për dallim prej vitit të kaluar kur mungesa e një biznes plani ishte problemi kryesor, në këtë vit kompanitë respondente kanë përmendur *raportimin financiar të pazhvilluar (25%)* dhe *profitabilitetin e ultë (24%)*.

Studimi përfundon me një numër të konkluzioneve dhe rekomandimeve. Në kuadër të rekomandimeve janë përfshirë edhe sygjerimet e kompanive dhe propozimet e tyre për tejkalim të vështirësive. Sipas tyre, adresimi i saktë i këtyre barrierave mund të ndihmojë për të krijuar një mjedis të përshtatshëm në të cilin kompanitë mund të veprojnë më mirë dhe të ndihmohen për të tejkaluar ato, ose të përballen më lehtë me këto barrierë.

1. HYRJE DHE JUSTIFIKIM / ARSYETIM

Megjithë përparësitë e shumta të saj, Kosova mbetet relativisht mbrapa në aspektin ekonomik dhe social dhe konsiderohet si një burim i mundshëm i paqëndrueshmërisë sociale dhe politike. Bruto Produkti i Brendshëm (BPB) po rritet ngadalë për shkak të politikave të dobëta ekonomike dhe jostabilitetit politik dhe qeverisës. Vendi ynë vuan nga papunësia e lartë (sidomos tek gratë dhe të rinjtë), arsimi i dobët, niveli i lartë i pabarazisë në të ardhura, diskriminimi gjinor, infrastruktura tejet e pazhvilluar, dhe një klimë e dobët biznesi. Për të kapërcyer këto pengesa zhvillimore, Kosova duhet të bëjë reforma gjithëpërfshirëse të sistemit të saj ekonomik, social dhe politik me qëllim të sigurimit të stabilitetit makroekonomik, rritjen ekonomike, hapjes së tregjeve dhe investimeve, përmirësimin e klimës së biznesit, fuqizimin e rendit dhe të ligjit, luftimin e krimit dhe korrupsionit dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe kapitalit njerëzor.

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2018 u përball me vështirësi të ndryshme. Në përgjithësi siç është raportuar edhe në studimin e rregullt tremujor të OEK-ut, konfidenca e biznesve ka treguar trend në rënie në quartale të caktuara. Kjo kryesisht për shkak të jostabilitetit politik dhe mungesës së një platforme të qartë për përkrahje të bizneseve kosovare, veçanërisht sektorit prodhues. Mungesa e parasë së gatshme në vend ka pasur ndikim të madh në fuqinë blerëse, duke ndikuar në nivel të ultë të shitjeve, kryesisht për sektorin e tregtisë.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), në tremujorin e tretë të vitit 2018 gjithsej janë regjistruar 2212 ndërmarrje, që paraqet një rënie për 16.1% krahasuar me tremujorin e dytë 2018. Rënie për 0.1% të ndërmarrjeve të regjistruara vërehet edhe nëse e krahasojmë me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM3 2017)ⁱ. Megjithëse nuk mund të matet ndikimi që shkaktojë këtë rënie, ndër faktorët kryesor mund të ceken klima e pafavorshme biznesore dhe ndikimi i agjendës politike në të bërit biznes në Kosovë.

Tutje, sipas ASK, Bruto Produkti Vendor në tremujorin e tretë (TM) të vitit 2018 shënoi rritje reale për 3.4 % në krahasim me TM3 të vitit 2017. Rritja reale e BPV-së sipas aktiviteteve ekonomike është si vijon: aktivitetet financiare dhe të sigurimit 19.8%, ndërtimtaria 15.4%, afarizmi me pasuri të patundshme 2.6%, hotelet dhe restorantet me 2.0%, bujqësia, gjuetia, pylltaria 1.9%, transporti dhe magazinimi 1.7%, tregtia me shumicë dhe pakicë 1.4%, administrimi publik 1.1%ⁱⁱ.

Profili ekonomik i Kosovës edhe në vitin 2018 nuk arriti të ndryshonte dhe të pasqyronte një gjendje më ndryshe nga vitet e kaluara. Në tremujorin e tretë të vitit 2018, shkalla e papunësisë ishte 30.7 %, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (TM3-2017) kemi rritje të shkallës së papunësisë me 0.5%. (ASK, 2018).ⁱⁱⁱ Këto rrethana të pafavorshme për punë dhe një kosto jetese shpeshherë të papërbalueshe kanë ndikuar poashtu në shkallën e varfërisë.

Dërgesat e mërgimtarëve që jetojnë dhe veprojnë në diasporë kanë minimizuar sadopak mundësinë e thellimit të varfërisë në vend. Anipse vlera e remitencave është e lartë, ato kryesisht janë shfrytëzuar për konsum dhe më pak për investime.

Në Kosovë, pas shkallës së lartë të papunësisë, jo stabilitetit politik dhe shkallës së varfërisë ose nivelit të ulët të jetesës, krahas tyre në shkallë të lartë rënditet korrupsionit në të gjitha nivelet, infrastruktura biznesore ende nuk është ndërtuar mjaftueshëm, sistemi arsimor aktual nuk promovon vetëpunësimin si një opSION karriere dhe jo qëndrueshmëria biznesore mund të shihet si njëra nga shkaqet sistematike të shkallës së lartë të dështimit të sektorit privat.

Kosovës i nevojiten strategji afatgjata, të adaptueshme dhe lehtë të implementueshme sipas nevojave të vendit. Strategjitë për të krijuar punësim do të duhet të mbështeten në përmirësimin e konkurrencës së brendshme dhe të jashtme, e cila do të varet nga faktorë të tillë si përmirësimi i kapitalit njerëzor duke nënkuptuar investime në edukimin joformal, tërheqja e investimeve të huaja duke konsideruar fillimisht sigurinë në investime, hapja e mëtejme e ekonomisë me botën e jashtme dhe veçanërisht fokus duhet të ketë rritja e eksportit dhe e aftësisë konkurruese të prodhimeve tona.

Fuqizimi i sektorit privat në Kosovë paraqet një sfidë në vete që nga paslufta. Megjithatë, kontributi i komunitetit të biznesit në ndërtim të shtetit është i pamohueshëm. Të kuptuarit e barrierave me të cilat përballen bizneset, natyrën e atyre pengesave, shtrirjen dhe impaktin që ato kanë është kushti elementar për të ndihmuar zhvillimin e tyre. Të kuptuarit e faktorëve të cilët janë duke penguar veprimtarinë biznesore në një moment kohor është me rëndësi, dhe kjo është ajo çfarë Oda Ekonomike e Kosovës është duke bërë tani me studimin biznesor mbi pengesat e të bërit biznes. Poashtu, monitorimi/ mbikqyrja e mjedisit/ ambientit për një kohë, së paku në ritëm vjetor, është me rëndësi. Me anë të krahasimeve kohore, mund të analizohet ndryshimi i mjedisit ekonomik dhe në këtë mënyrë mund të zbulohet çfarëdo lloj

përmirësimi apo përkeqësimi. Prandaj, realizimi i këtij studimi në baza vjetore, çfarë edhe synohet-është studimi i pestë i këtij lloji- i cili do të jetë edhe më i miri.

Ky studim hedhë dritë mbi problemet, të cilat janë perceptuar nga bizneset. Ndryshe nga disa studime ad-hoc të ndërlidhura me këtë temë, jo vetëm “fytat e ngushta” në ambientet jashtë kompanive (p.sh. infrastrukturë, standarde ndërkombëtare në tregti dhe prodhim, taksa, çasje në financa etj.), por poashtu probleme brenda kompanisë (si kualiteti i prodhimeve/ shërbimeve, mungesa e kanaleve të shpërndarjes, mungesa e investimeve në staf brenda kompanive, mungesa e një plan biznesi adekuat, etj.) janë të monitoruara.

Të dhënat janë të ndara sipas sektorit të cilit i përket kompania si dhe madhësisë së kompanisë. Raporti gjithashtu përfshin aspektin rajonal/komunat, me qëllim që të identifikohen pengesat në bazë të ndikimeve rajonale.

OEK ofron një raport të progresit të pengesave të jashtme dhe të brendshme me të cilat kompanitë ballafaqohen në të bërit biznes. Ky informacion do t’ju ndihmojë të gjithë agjentëve ekonomik – politikave ekonomike si dhe vetë menaxhmentit- që të implementojnë masa për të përmirësuar mjedisin biznesor.

Rezultatet e paraqitura në këtë raport janë bazuar në një studim të gjërë biznesor. Oda Ekonomike e Kosovës ka zhvilluar pyetësin dhe mëpastaj e ka implementuar studimin. Studimi është bërë përmes intervistave personale në periudhën kohore nga 3 deri me 21 Dhjetor 2018. Oda Ekonomike e Kosovës për qëllim të studimit ka intervistuar 437 kompani.

Studimi reflekton situatën e kompanive gjatë vitit 2018. Raporti është përgatitur nga znj. Olivera Ceni Bardiqi - Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Politikave në Odën Ekonomike të Kosovës.

Raporti fillon me pengesat e jashtme, ashtu si janë parë nga kompanitë, të pasuara nga faktorët e brendshëm që i kërcënohen biznesit. Tema e dytë më kryesore merret me investimin e planifikuar dhe pritjet e shitjeve për vitin 2019.

Rezultatet janë analizuar në bazë të sektorit dhe madhësisë. Të madhësisë, mikro prej 1 – 2 punëtorë, të vogla nga 2 deri në 10, të mesme nga 10 deri në 50, dhe e madhe mbi 50 punëtorë.

2. PENGESAT JASHTË KOMPANISË

Kosova në raportin e të bërit biznes të publikuar nga Banka Botërore në vitin 2018 ra për katër vende, duke nënkuptuar përkeqësim të ambientit biznesor.

Problemet e raportuara ndër vite vazhdojnë të jenë akoma pengesa të mëdha në zhvillim të bizneseve. Sado që bizneset raportojnë pritje të larta për përmirësim të gjendjes së biznesit, rritje të numrit të punëtorëve dhe zhvillim të qëndrueshëm, vetëm një pjesë simbolike e këtyre pritjeve përmbushet. Kjo kryesisht si rezultat i faktit që bizneset kosovare në përqindje më të lartë janë mikro dhe të vogla dhe njihërit mundësia e tyre për rritje të investimeve dhe zhvillim është më e limituar dhe kjo jo pa shkak kur analizojmë faktorët që penguan më së shumti zhvillimin e ndërmarrjeve në vitin 2018. Megjithatë bizneset e vogla kanë rol crucial në vendet në zhvillim dhe ekonomitë në tranzicion, siç është Kosova. Vendet e zhvilluara zakonisht aplikojnë modele të tilla të rritjes dhe zhvillimit të bizneseve përmes përshtatjes së mjedisit biznesor me nevojat e sektorit privat kryesisht duke fuqizuar rendin dhe ligjin në vend dhe përmes përkrahjes direkte financiare të kompanive/subvencionimit.

Të kuptuarit e sfidave të bizneseve është akti kryesor në orientim të përmirësimit të gjendjes.

Sipas këtij hulumtimi, ndër problemet kryesore me të cilat ballafaqohen ndërmarrjet kosovare është qasja në burimet e jashtme të financimit. Mungesa e financave njihet si një nga pengesat në rritjen e NVM-ve në të gjithë botën, sidomos në ekonomitë në zhvillim. Vështirësi në qasjen në financa kanë pasur kompanitë tona, veçanërisht në marrjen e produkteve financiare (depozitat dhe kreditë) dhe shërbimet (sigurimet dhe produktet e kapitalit) të cilat janë me një kosto të papërbalueshme. Vështirësitë në sigurimin e pengut (kolateralit) me theks të veçantë për ndërmarrjet mikro dhe të vogla të cilat njihërit përbëjnë pjesën më të madhe të kompanive të anketuara pa dyshim kanë influencuar rezultatet e këtij studimi. Pamundësia e mbulimit të pengut nga njëra anë dhe nga ana tjetër kostoja dhe mos-përshtatshmëria e produkteve të ofruara e kanë bërë huamarrjen jopraktike, si rezultat i së cilës bizneset e kanë të pamundur të përfitojnë.

Bizneset deklarojnë të kenë vështirësi në sigurimin e kolateralit që është i pranueshëm për huadhënësit/bankat. Kjo kryesisht për shkak se bizneset, me theks të veçantë ato mikro dhe të vogla nuk kanë pasurinë e nevojshme për t'u përdorur si kolateral ose nuk kanë aftësi dhe përvojë që të menaxhojnë dhe mbajnë asetet e tyre për nevojat e huamarrjes.

Në parim, ndërmarrjeve u duhet qasja në financa për disa arsye bazike: (a) për kapital fillestar/start-up, (b) për kapital qarkullues, dhe (c) për kapitalin fiks. Mundësia e limituar e qasjes në këto tre llojeve të kapitalit mund të ketë ndikuar dhe kufizuar rritjen e shumicës dërmuese të bizneseve të anektuara. Rrjedhimisht, qasja në financa ka mbetur padyshim një nga pengesat më të mëdha për bizneset fillestare/të reja dhe rritjen e bizneseve ekzistuese.

Bankat komerciale në Kosovë, sipas një studimi të realizuar nga OEK-u në vitin 2017, aplikojnë politika që të mos financojnë bizneset më të reja se gjashtë muaj, duke përjashtuar kështu mundësinë e ndërmarrësve të rinj për qasje në financa. Nga ana tjetër, institucionet mikrofinanciare ofrojnë këtë mundësi, por normat e kredisë janë tejet të larta dhe jo të përballueshme për bizneset e reja.

Tutje, bizneset përmendin koston e lartë për transaksione bankare dhe normat e kredive ndër arsyet tjera, anipse normat e kredisë në vend kanë rënë konsiderueshëm krahasuar me vitet paraprake. Nga ana tjetër norma e interesit është kryesisht interesi bazë, shkalla e rrezikut në kthim të kredisë dhe shpenzimet e administrimit. Sipas bankave dhe institucioneve mikrofinanciare në parim, shkalla e rrezikut përbën peshën më të madhe në përcaktim të normës së interesit. Por, në studimet paraprake të OEK-ut, ku është analizuar shkalla e kredive jo performuese të deklaruara nga vet bankat komerciale dhe institucionet mikrofinanciare në Kosovë, kreditë joperformuese në vend janë tejet e ulta dhe sillen mes 1% dhe 3%. Në përgjithësi, kostot e larta të transaksioneve, norma e interesit, plani i dobët i biznesit, mungesa e aftësisë për të shlyer kredinë ishin disa nga faktorët me ndikim që penguan shumicën e bizneseve kosovare për të pasur qasje në financa.


Në kuadër të studimeve që janë bërë në këtë fushë, Alauddin dhe Chowdhury (2015)^{iv} flasin për mos-disponibilitetin e kredive adekuate dhe të nevojshme për bizneset, procedurën tejet komplekse të dhënies së kredive, mungesën e lehtësirave infrastrukturore, problemet me kërkesën e kolateralit dhe kapitalit të vogël punues si pengesa për marrjen e kredive nga institucionet financiare.

Kjo e gjetur sinjalizon qartë mungesën e parasë së gatshme në vend dhe jo qëndrueshmërinë financiare të bizneseve tona.



2.1 Dhjetë pengesat kryesore për veprimtari biznesore në Kosovë


Hulumtimi ka radhitur dhjetë pengesa kryesore, të paraqitura si në vijim:



Tutje, edhe në vitin 2018, kostoja e lartë e energjisë elektrike dhe furnizimi jo i rregullt me energji elektrike mbeten top barrierë. Sektori privat në Kosovë me gjasë do të vazhdojë të përballet me këtë problem derisa të krijohen kushtet dhe rrethanat për ndërtim të termocentralit të ri, projekt ky që mund të ketë sfida në implementim. Megjithatë, komuniteti i biznesit ruan një dozë optimizmi për përmirësim të furnizimit me energji elektrike kur ky termocentral të funksionalizohet, sado që kanë shqetësim mbetet mundësia e rritjes së çmimit të energjisë.

Krahasuar me vitin 2017, bizneset kanë raportuar përqindje më të ultë të pengesës nga konkurrenca jo lojale nga ekonomia e hirtë. Përderisa në vitin paraprak rreth 61 përqind e ndërmarrjeve rankuan atë si barrierën kryesore, në vitin 2018 kjo përqindje ra në 43%. Institucionet relevante në vend kanë vazhduar luftën ndaj informalitetit dhe korrupsionit gjë që duket të ketë ndikuar në perceptimin e bizneseve në rënie të shkallës së këtyre fenomeneve. Bizneset rëndisin korrupsionin si problemin e dhjetë më të rëndësishëm me të cilin ballafaqohen.

2.1.1 Top dhjetë pengesat (në përqindje) ndër vite (2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018)



2.1.1 Përmbledhje e pengesave për bizneset: Mjedisi ekonomik


Përdrisa në vitin 2017, konkurrenca jolojale nga ekonomia e hirtë ishte pengesa kryesore në kuadër të kategorisë së barrierave të mjedisit ekonomik, këtë vit si barrierë kryesore paraqiten të jenë qasja në financa (49%). Si barrierë e tretë në kuadër të mjedisit ekonomik është mungesa e kërkesës për rreth 35 përqind të kompanive të anketuara.

Bizneset kosovare u përballën me mungesë të kërkesës (35%) për produktet/shërbimet e tyre. Shikuar nga një dimension më i gjerë, kjo mund të ketë arsyeshmërinë tek çmimet e larta që ato mund të kenë si produkte finale në treg duke marrë për bazë barrierat dhe vështirësitë me të cilat përballen bizneset të cilat detyrimisht pasojnë rritjen e çmimit final në pamundësi për t'i bërë ballë konkurrencës ose, rënia e fuqisë blerëse si rezultat i rritjes së kostos së jetesës në vend dhe shkallës së lartë të papunësisë.

Natyrshëm dihet që faktori themelor që kufizon rritjen në ekonomitë e zhvilluara është niveli i kërkesës dhe në ekonomitë në zhvillim kufizimi kryesor është mungesa e kapaciteteve prodhuese. Duke ditur se kërkesa e pamjaftueshme është shkaku kryesor i rritjes së ulët kjo nënkupton që vendi ynë duhet të stimulojnë instrumentet kryesore që nxisin rritjen e kërkesës. Stimulimi i kërkesës përmes zgjerimit të kapaciteteve do të jetë thelbësor për rritjen afatshkurtër dhe afatgjatë. Në ekonomitë në zhvillim, efekti i investimit është padyshim pozitiv, duke rritur kapacitetin, ajo mundëson rritje të punësimit dhe zhvillim të kompanisë. Rrjedhimisht, rritja e punësimit do të rrisë aftësinë blerëse dhe do të zbusë barrën sociale.

Investimet private gjithashtu nuk do të rriten nëse firmat kanë kapacitete të papërdorura dhe kanë vështirësi në menaxhim të borxheve. Në këto rrethana, çdo stimul për rritje të kërkesës duhet të iniciohet nga jashtë sektorit privat, për shembull nga rritja e shpenzimeve publike ose nëpërmjet shkurtimeve të taksave, d.m.th. përmes politikës fiskale.


Barrierat e mjedisit ekonomik



Tutje, mungesa e stafit të kualifikuar (16%) paraqitet të jetë problem në këtë kategori të barrierave, sado që krahasuar me vitin paraprak, gjendja duket shumë më e mirë me një përmirësim të gjendjes për 16 p.p. Ndërsa, rreth 13% e kompanive pjesëmarrëse në studim përmenden probleme me likuiditetin.



Barrierat e mjedisit ekonomik (në përqindje) sipas viteve



Siç mund edhe të shihet nga figura e mësipërme, krahasuar me pesë vitet e fundit, barrirat e mjedisit ekonomik kanë qenë më të vogla, përveç vështirësive në qasje në financa, barrierë e cila në vitin e fundit shënon një rritje prej 11 p.p krahasuar me vitin paraprak.

2.1.2 Përmbledhje e pengesave për kushtet administrative dhe rregullatore

Mungesa e ligjeve adekuate duket të jetë problemi kryesor në kuadër të barrierave administrative dhe rregullative. Komuniteti i biznesit kosovar hendekun e krijuar nga mungesa e legjislacionit të përshtatshëm shpeshherë e interpretojnë si mungesë të ligjeve. Në fakt ajo çfarë bizneset interpretojnë në këtë pikë është mospërputhja e ligjeve që Kuvendi i Kosovës miraton me nevojat dhe kapacitetet e kompanive tona dhe njiherit mos zbatueshmëria e atyre ligjeve.


Ligjet shpeshherë janë kopjuar nga vendet e BE-së, por zbatimi i tyre në praktikë ka qenë sfidë për shkak të nivelit të ultë të zhvillimit të bizneseve në krahasim me vendet prej nga është marrë modeli për hartim të ligjeve. Disa prej ligjeve sipas kompanive shpeshherë kanë qenë pengesë madhore në rritjen dhe zhvillimin e tyre, kryesisht në pamundësi për të përmbushur obligimet që rrjedhin nga to.

Është mëse e nevojshme që fillimisht të iniciohet zhvillimi i kuadrit ligjor për zhvillimin dhe fuqizimin e bizneseve, krijimi (miratimi) i ligjeve të veçanta dhe akteve normative që përkrahin sektorin prodhues në vend, futja e shpejtë e ndryshimeve në dokumentet ekzistuese normative për të përforcuar kuadrin ligjor për zhvillimin e bizneseve dhe paraqitja e ndryshimeve në (pranimin) e dokumenteve aktuale normative që lidhen me proceset e përgjithshme, por që rregullojnë sferat e veprimtarisë ekonomike të vendit si një tërësi.

Për më tepër përveç mungesës së ligjeve adekuate, bizneset kanë probleme edhe me mos zbatimin e kontratave dhe njiherit mungesën e mbështetjes ligjore në zbatim të tyre. Në përgjithësi bizneset këtu u referohen kontratave mes furnitorëve, të cilat shpeshherë mbesin në mëshirën dhe vullnetin e palëve për t'u ekzekutuar dhe për t'u përmbushur marrëveshja e paraparë me kontratë. Mos efikasiteti i gjykatave dhe zvarritja e lëndëve ka bërë që kompanitë mos ta kenë si opsjon gjykatën për zgjidhjen e kontesteve. Nga ana tjetër, një numër poashtu i vogël i kompanive shfrytëzojnë arbitrazhin për zgjidhje të mosmarrëveshjeve. Theksojmë se në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës tash e disa vite me radhë është funksionale Gjykata e Arbitrazhit e cila ka zgjidhur konteste për bizneset vendore dhe ndërkombëtare.



Barrierat administrative




Krahasuar me vitin 2017, barrierat e kuadrit administrativ janë përmirësuar dukshëm. Përderisa në vitin paraprak rreth 14% e kompanive deklaruan që lejet e ndërtimit ishin barrierë kryesore, në vitin 2018 kjo përqindje ka rënë në 6%.

Tutje, 11% e kompanive pjesëmarrëse në studim në vitin e kaluar e konsideronin regjistrimin e biznesit si barrierë, në këtë vit vetëm 5 përqind e kompanive e renditen atë mes barrierave të mëdha.

Përmirësim vërehet edhe tek licencat për eksport dhe import, respektivisht vetëm 6% këtë vit e nënvizuan atë si problem, për dallim prej rreth 14% sa ishte në vitin 2017. Procedurat për pajisje me licencë për eksport/import sipas kompanive janë përmirësuar dukshëm, sado që ende mbetet hapsirë për përmirësime, veçanërisht sa i takon opinionit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në vendin tonë.

Barrierat administrative (në përqindje) sipas viteve



2.1.3 Përmbledhja e pengesave të infrastrukturës dhe kushteve të përgjithshme

Sipas të të gjeturave, kategoria e pengesave infrastrukturore mbetet ende në top 10 barrierat. Gjatë vitit 2018, kostoja e energjisë elektrike (49%) dhe furnizimi (46%) jo stabil me energji ishin barrierë madhore. Pavarësisht adresimeve të shumta dhe diskutimeve publike rreth kësaj teme, pak është përmirësuar gjendja. Madje gjatë tremujorit të fundit të vitit 2018, pati shpeshherë edhe tone të ngritura të qeverisë së vendit rreth furnizimit me energji elektrike. Stabiliteti në furnizim me energji elektrike duket të jetë synim i vështirë për secilën qeveri që nga paslufta. Nga ana tjetër bizneset janë dëmuar shumë në aspektin financiar nga mungesa e infrastrukturës ligjore në këtë fushë. Bizneseve shpesh u kërkohet që të paguajnë kyqjet në sistemin energjetik, investimet në trafo dhe në fund këto investime kalojnë në pronësi të KEDS-it, duke përbërë një situatë paradoksale. Për këtë gjendje tani e disa vite nuk ka asnjë zgjidhje.

Tutje, jo stabiliteti politik dhe dominimi i agjendës politike ishte problem për funksionim të rreth 25% të bizneseve pjesëmarrëse në studim. Në përgjithësi bizneset kishin dyshime nëse duhej të investonin për shkak të paqëndrueshmërisë politike. Njëjtë siç është raportuar edhe në vitet paraprake, në kohën kur në vend ka paqëndrueshmëri politike aktiviteti biznesor bie. Bizneset kanë përmendur një grup të gjerë të faktorëve të paqëndrueshmërisë politike duke përfshirë korrupsionin, paqëndrueshmërinë e qeverisë, konfliktet, tensionet fetare dhe etnike, përgjegjshmërinë demokratike dhe burokracinë.


Paqëndrueshmëria politike është një nga temat konvencionale të teorisë moderne të ekonomisë politike. Teoria moderne e ekonomisë politike thotë që stabiliteti politik luan një rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike të një vendi. Kështu, një sistem politik i paqëndrueshëm mund të pengojë seriozisht rritjen ekonomike. Brenda kuadrit teorik të ekonomisë moderne politike, qeveria konsiderohet e paefektshme nëse objektivat e politikës ndryshojnë për një periudhë të shkurtër kohore. Kështu, qeveritë e koalicionit janë një kërcënim serioz dhe më i prirur për jostabilitetin politik. Për më tepër, teoria e ekonomisë moderne politike thekson se paqëndrueshmëria politike gjithashtu ndikon tek niveli i rritjes ekonomike në vend meqenëse ka një korrelacion mes shkallës së rritjes ekonomike dhe politikave të qeverisë dhe si qeveria i ushtron këto politika (Barro, 2013).

Rrjedhimisht, paqëndrueshmëria politike krijon joefikasitet ekonomik. Një nga argumentet më të rëndësishme teorike prapa kësaj teme është se paqëndrueshmëria politike përveç që është një pengesë serioze për rritjen ekonomike është edhe pasiguria që shkakton një mjedis politik i paqëndrueshëm në vendimet për investime dhe rrjedhimisht mbi normën e rritjes

ekonomike.

Për më tepër shkalla e lartë e korrupsionit në nivel lokal dhe qendror është përmendur si pengesë nga rreth 22% e kompanive. Korrupsioni çon në uljen e të ardhurave nga tatimet, kufizon aftësinë e qeverive për të siguruar nivel të mjaftueshëm të shërbimeve publike për zhvillimin e sektorit privat. Komuniteti i biznesit janë të vetëdijshëm që nga kjo shkallë e lartë e korrupsionit, të gjithë humbin, jo vetëm bizneset, por edhe qytetarët dhe qeveria.


Barrirat infrastrukturore dhe kushtet e përgjithshme



Bizneset kosovare në shkallë të lartë kanë raportuar rritjen e krimit, vandalizmit dhe vjedhjes në vitet e fundit. Niveli mbetet shumë shqetësues dhe në tremujorin e katërt të vitit 2018 ky fenomen u bë tejet e përhapur, pa dallim për profilin apo madhësinë e kompanive. Megjithatë bizneset e rajonit të Prishtinës raportuan në shkallë më të lartë këtë problem.



Barrierat e kategorisë infrastrukturore (në përqindje) sipas viteve



Barrierat e dimensionit infrastrukturor kanë mbetur pothuajse të njëjta në katër vitet e fundit, me gjithë ndryshimet e lehta që kanë pësuar ndër vite, qoftë në përmirësim ose në përkeqësim të gjendjes. Përveç energjisë elektrike, barrierat e tjera të këtij seksioni duket të kenë ndikim më të vogël në rrjedhën e biznesit. Kompanitë kosovare edhe në vitin 2018 nuk kanë përmendur shumë problemin e furnizimit me ujë dhe aspektin e transportit.

2.2 Pengesat sipas sektorit

Studimi i "Fyteve të ngushta", si çdo vit analizon barrierat sipas sektorëve. Sa i takon faktorëve të brendshëm të industrisë, kompanitë e sektorit të tregtisë me shumicë kanë raportuar problemin më të madh profitabilitetin e ultë (40%), pasuar nga mungesa e raportimit financiar të pazhvilluar si duhet (38%).

Tutje, rreth 35% e kompanive të sektorit të tregtisë me shumicë kanë deklaruar të mos kenë plan të biznesit të zhvilluar. Plani i biznesit është një mjet thelbësor për ndërmarrësit që udhëheqin një biznes ose kërkojnë të gjejnë partnerë biznesor, poashtu është tejet e rëndësishme edhe për të aplikuar për projekte dhe financime nga donatorët dhe subvencione nga shteti. Pavarësisht kësaj, bizneset ankohen për koston e lartë që aplikojnë konsulentët apo palët tjera për të ua dizajnuar një plan biznesor, duke arsyetuar kështu mungesën e këtij dokumenti nëpër kompani.

Sektori i prodhimit në vend përballet me shkallën më të lartë të problemit me koston e lartë të energjisë elektrike (71%) dhe mungesën e furnizimit të rregullt me energji (65%).


Sektori i ndërtimit në vend ka raportuar problem të madh qasjen në financa për rreth 60% të kompanive pjesëmarrëse në studim. Sektori i ndërtimit përballet poashtu me shkallë të lartë të konkurrencës jo lojale nga ekonomia e hirtë (59%). Procesi për të luftuar dhe raportuar konkurrencën e padrejtë shpesh është zhgënjyese për bizneset, sepse faktet e perceptuara dhe të prezantuara për shumë nga faktorët që përdoren për të përcaktuar atë shpesh janë subjekt i ndryshimeve gjatë rrjedhës së zbulimit dhe gjatë procesit të përgatitjes për gjykim. Andaj, bazuar në këto pohime të tyre, kjo është arsyeja që bizneset nuk kanë raportuar atë.

Krimi dhe vandalizmi janë raportuar të jenë problem madhor për rreth 25 përqind të kompanive të sektorit të shërbimeve, pasuar nga vonesat në pagesa nga ana e konsumatorëve (35%). Mungesa e parasë së gatshme në vend ka ndikuar në shkallë të madhe rritjen e kësaj përqindje krahasuar me vitet paraprake. Shkalla e lartë e korrupsioni (26%) është theksuar gjithashtu nga sektori i shërbimeve si pengesë e madhe për zhvillimin dhe funksionimin e tyre.

Sektori i tregtisë me pakicë përveç koston së lartë të energjisë dhe normave të larta të interesit kanë deklaruar të kenë prblem edhe me raportet financiare (38%) të cilat nuk janë mirë të zhvilluara dhe si rezultat i kësaj janë shpesh subjekt i ndëshkimeve nga institucionet përgjegjëse të vendit.



Barrierat sipas sektorëve (në përqindje)



2.3 Pengesat sipas madhësisë së kompanisë

Sipas madhësisë së kompanisë, ndërmarrjet mikro dhe të vogla raportojnë numrin më të madh të barrierave në nivel vendi. Në kuadër të faktorëve të brendshëm, 43% e kompanive mikro kanë deklaruar të kenë probleme me profitabilitetin, duke theksuar që e kanë të pamundur të mendojnë për investime të mëdha. Për më tepër ndërmarrjet e vogla kanë raportuar përqindjen më të lartë të mos pasjes së raportimit financiar të zhvilluar (38%) sipas standardeve, duke shkaktuar kështu vështirësi të mëdha për ta në qasjen në financa, veçanërisht tek bankat komerciale dhe institucionet mikrofinanciare.

Sa i takon barrierave infrastrukturore dhe kushteve të përgjithshme, sërish problemet janë më të theksuara tek ndërmarrjet mikro dhe të vogla. Megjithatë, edhe ndërmarrjet e mëdha kanë raportuar koston e energjisë elektrike (65%) si barrierën më madhore. Paqëndrueshmëria politike është barrierë për 36% të ndërmarrjeve mikro dhe 21% të ndërmarrjeve të mesme, pjesëmarrëse në këtë studim.


Vështirësi në qasjen në financa kanë raportuar 59% e ndërmarrjeve mikro në kuadër të barrierave të natyrës ekonomike. Konkurrenca jolojale nga ekonomia e hirtë është problem për 37% të ndërmarrjeve të mëdha në vend. Ndërmarrjet e mëdha kanë raportuar përqindje më të lartë të mungesës së stafit të shkathtë, respektivisht 28%, pasuar nga ndërmarrjet mikro me 27% dhe ato të mesmet me 26%. Ndërmarrjet mikro (27%) dhe ato të mëdha (28%) ballafaqohen edhe me vonesa në pagesa nga ana e konsumatorëve.

Ndërmarrjet e mesme në Kosovë kanë raportuar probleme më të mëdha të natyrës administrative dhe rregullative. Mungesa e ligjeve adekuate përbën barrierë për 19% të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Përderisa, mos zbatimi i kontratave është barrierë për 15% të ndërmarrjeve të mëdha në Kosovë.

Kostoja e lartë për të implementuar standardet ndërkombëtare është njëra prej barrierave më të theksuara poashtu në kuadër të kësaj kategorie. Në përqindje vështirësi më të madhe kanë raportuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, respektivisht me 14% secila. Sipas ndërmarrjeve kosovare, mungesa e konsulencës në fushën e standardizimit dhe certifikimit nga njëra anë dhe kostoja e lartë që ato kanë nga ana tjetër kanë vështirësuar shumë mundësitë e tyre, veçanërisht kur bëhet fjalë për depërtim në tregjet e huaja, ku pajisja me sisteme të cilësisë dhe standarde ndërkombëtare është kriter themelorë.



Barrierat sipas madhësisë së kompanisë (në përqindje)



2.4 Pengesat sipas rajoneve

Shikuar nga dimensionimi rajonal, bizneset e rajonit të Ferizajt kanë raportuar përqindjen më të lartë të barrierave, pothuajse në të gjitha kategoritë e analizuar. Megjithatë, barrierat e ambientit ekonomik janë më të theksuarat, duke filluar nga vështirësitë në qasjen në financa për rreth 98% të kompanive të rajonit të Ferizajt, pasuar nga rreth 71% e kompanive të rajonit të Gjakovës që kanë raportuar të njëjtin problem. 91% e kompanive të rajonit të Ferizajt përballen me mungesë të kërkesës për produktet/shërbimet e tyre, pasuar nga 67% e bizneseve të rajonit të Gjakovës.

Konkurrenca jo e drejtë nga ekonomia e hirtë është barrierë madhore për 58% të kompanive të anketuara të rajonit të Pejës. Bizneset e këtij rajoni përballen në shkallë të lartë edhe me vonesat në pagesa nga ana e konsumatorëve (46%). Korrupsioni (50%) raportohet të jetë problemi më i theksuar për bizneset e Pejës, në krahasim me të gjitha rajonet e tjera.


Tutje, në kuadër të barrierave infrastrukturore, bizneset e rajonit të Prizrenit raportuan vështirësi në operim të biznesit si rezultat i krimit, vandalizim dhe vjedhjeve (28%), pasuar nga bizneset e rajonit të Prishtinës (26%).

Zonat/rajonet e rrethuara nga krimi janë shpesh vende të cilave përveç rrezikut gjithashtu u mungojnë një numër lehtësirash në të bërit biznes, ndër të tjera duke përfshirë edhe mungesën e bizneseve të reja. Sa i takon aspektit të të ardhurave, krimi mund të pengojë afrimin e klientëve potencialë dhe të zvogëlojë kërkesën për produkte ose shërbime. Krimi gjithashtu mund të rrisë kostot e operimit. Bizneset në këto rrethana do të duhet të punësojnë personelin e sigurisë për të mbrojtur mallrat ose punëtorët gjatë ose jashtë orarit të punës. Madje, kostot shtesë të punës mund të vijnë gjithashtu nga niveli i pagave më të larta për punëtorët të cilët duhet kompensuar për shkallën e lartë të rrezikut që mund t'u kanoset stafit në vendin e punës.

Bizneset e rajonit të Gjilanit dhe Mitrovicës kanë raportuar probleme më të vogla në krahasim me rajonet e tjera, megjithatë, barrierë për to ndër të tjera mbeten energjia elektrike dhe mungesa e stafit të shkathtë.



Barrierat sipas rajoneve (në përqindje)



3. PENGESAT E BRENDSHME

Në kapitullin tre do të diskutohen faktorët e brendshëm. Pavarësisht faktit që bizneset deklarohen për shkallë të ultë të fitimit (24%), problem më madhorë në vitin 2018 në kuadër të barrierave të brendshme të kompanisë është raportimi financiar i pazhvilluar për rreth 25% të kompanive të anketuara. Sipas kompanive si rezultat i mos njohurive dhe kufizimeve buxhetore për të investuar në staf shtesë në fushën e financave, shpeshherë janë ndëshkuar nga inspektorët për raportim jo të rregullt. Në këtë pikë rekomandim i një pjese të madhe të kompanive ka qenë rritja e bashkëpunimit me Administratën Tatimore të Kosovës, respektivisht njësinë për këshillim të tatimpaguesve, duke nënkuptuar organizimin e sesioneve informuese, trajnimeve, seminareve ose punëtorive që do të ndikonin në ngritjen e njohurive të bizneseve në aspektin e raportimit financiar.


Tutje, në kuadër të këtyre barrierave rreth 18 përqind e kompanive deklaruan të mos kenë plan të biznesit të zhvilluar.

Ndërsa, rreth 16% e kompanive theksuan të mos kenë produkte kualitative sa të mund t'u bëjnë konkurrencë produkteve të rajonit dhe atyre të BE-së. Në këtë pikë shumica e bizneseve ishin të një zërit që në mungesë të implementimit të sistemeve të cilësisë dhe standardeve të ndryshme ndërkombëtare, gjendja nuk mund të përmirësohet dhe produktet tona nuk po mundën të ju bëjnë ballë "agresivitetit" të produkteve nga vendet tjera.

Mungesa e kanaleve të shpërndarjes është barrierë madhore për rreth 14% të kompanive.




Faktorët e brendshëm



Shikur ndër vite, barrierat e faktorëve të brendshëm të industrisë kryesisht kanë qenë subjekt i përmirësimit të gjendjes. Megjithatë, në këtë vit rritja e përqindjes së kompanive që përballen me vështirësi në raportim financiar sinjalizon nevojën e madhe që ato kanë në zhvillim dhe aftësim në aspektin e menaxhimit të financave.

Barrierat e faktorëve të brendshëm (në përqindje) sipas viteve






3.1 Faktorët e brendshëm sipas sektoreve

Profitabiliteti i ultë është paraqitur të jetë problem për shumicën e sektorëve, veçanërisht për sektorin e tregtisë dhe atë të prodhimit. Bizneset e anketuara të sektorit të tregtisë kanë raportuar pashtu probleme si rezultat i raportimit financiar të pazhvilluar. Nga ana tjetër rreth 30% e kompanive ndërtimore kanë raportuar si barrierën më të madhe mungesën e kanaleve të shpërndarjes.

Faktorët e brendshëm në industri (në përqindje) sipas sektorëve




4. TENDENCAT E KOMPANIVE

Në figurën e mëposhtme janë paraqitur vlerësimet për nivelin e shitjeve të kompanive pjesëmarrëse në këtë hulumtim gjatë vitit 2018. Ndërmarrjet kosovare në përqindje më të lartë kanë deklaruar shitjet prej 10 000 deri në 50 000 Euro, respektivisht 42%. Tutje, janë vetëm rreth 19% e kompanive të anketuara që kanë deklaruar të kenë pasur shitje mbi gjysmë milioni Euro gjatë vitit 2018. Shikuar nga dimensionin sektorial, rreth gjysma e ndërmarrjeve ndërtimore kanë deklaruar të kenë pasur shitje mbi €500 000, pasuar nga sektori i prodhimit (34%) dhe ai i tregtisë me shumicë (29%).

Ndërmarrjet e mëdha kanë raportuar përqindjen më të lartë të shitjeve mbi €500 000 (78%), pasuar nga ndërmarrjet e mesme (35%). Rreth 64% e ndërmarrjeve mikro kanë raportuar të kenë pasur shitje mes €10 000 dhe €50 000. Në kontekstin e shtrirjes rajonale, janë ndërmarrjet e rajonit të Mitrovicës që kanë raportuar nivel më të lartë të shitjeve, pasuar nga ndërmarrjet e rajonit të Prishtinës.


Vlerësimi i shitjeve për vitin 2018 (në Euro)






Viti 2019 duket të jetë mjaft premtues për bizneset tona. Mbi 78% e ndërmarrjeve të anketuara presin të kenë rritje të shitjeve në vitin 2019 duke dhënë një sinjal pozitiv për aktivitet të rritur biznesor gjatë vitit.

Pritjet për shitje për vitin 2019



Pritshmëri të mëdha për rritje të aktivitetit biznesor në gjysmën e parë të vitit 2019 është raportuar edhe në raportin e rregullt të Odës Ekonomike të Kosovës mbi klimën e biznesit në Kosovë. Megjithatë, pavarësisht pritjeve pozitive, jo gjithmonë ndërmarrjet kanë pasur mundësi të konkretizojnë këto pritje. Aktiviteti biznesor në vend gjatë vitit 2018 pati rënë, duke raportuar për një shkallë të ultë të konfidencës së biznesit, veçanërisht në tre kuartalët e parë të vitit 2018.

Pritjet për shitje në vitin 2019 (në %)



Rëndësia e shitjeve në suksesin e një firme dhe roli i forcës së shitjes në krijimin e vlerës për një firmë sjell mbështetje në pikëpamjen e shitjeve si një aftësi e rëndësishme për një firmë (Blocker et al. 2012).^v Shitja është një komponent e rëndësishme e gjenerimit të të ardhurave të një ndërmarrjeje dhe një lidhje vitale midis një ndërmarrjeje dhe klientëve të saj, prandaj roli i shitjeve ka rritur përfitimet e menaxhimit efektiv të forcës shitëse.

Sektori prodhues në vend ka pritjet më të larta për rritje të shitjeve në vitin 2019, pasuar nga sektori i tregtisë. Njiherit konsideruar faktin që këta dy sektorë përbëjnë kontributin më të madh në Bruto Produktin e Vendor (BPV), pritjet e larta të tyre janë një sinjal pozitiv për përmirësim biznesor në vend në njërin anë dhe rritje të mirëqenies në anën tjetër. Rritja e aktivitetit biznesor dhe performanca e shtuar e bizneseve me gjasë do të reflektojë në rritje të numrit të të punësuarve dhe rritjen e fuqisë blerëse, duke ndikuar kështu në uljen e shkallës së papunësisë dhe varfërisë në vendin tonë. Megjithatë, mbetet të shihet nëse trendi do të jetë pozitiv në gjysmën e parë të vitit, duke pasur parasysh që investimet e pritura nga ana e kompanive është raportuar të bëhen në gjysmën e parë të vitit.

Bizneset intensifikojnë konkurrencën, megjithatë se sa mund të rritet produktiviteti, kjo nuk mund të vërtetohet pa model të veçantë ekonometrik. Matja e aftësisë së tyre është ende më e vështirë duke pasur parasysh madhësinë e ndërmarrjeve kosovare. Për shembull, Davis et al. (1993)^{vi} tregojnë se ndërkohë që normat bruto të krijimit të vendeve të punës dhe




shkatërrimit të tyre janë më të larta në firmat e vogla, nuk ka lidhje sistematike midis krijimit të vendeve të punës dhe madhësisë së firmës. Nga ana tjetër, Biggs et al. (1998)^{vii} në analizën e tyre konstatojnë se firmat e mëdha ishin burimi dominues i krijimit të vendeve të reja të punës në sektorin e prodhimit. Natyrshëm edhe në vendin tonë, pavarësisht deklarimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, pritet që në punësim ndikim më të madh të kenë ndërmarrjet e mëdha.

Tutje, afërsisht 90% e ndërmarrjeve të anketuara kanë deklaruar të kenë fituar konsumatorë të rinjë në vitin raportues. Shikuar nga këndvështrimi sektorial, kompanitë shërbyese (92%) kanë raportuar rritjen më të madhe në numër të konsumatorëve të rinj, pasuar nga sektori i prodhimit (90%) dhe ai i tregtisë me pakicë (89%).

Numrin më të madh të klientëve të rinj e kanë raportuar ndërmarrjet e mëdha (94%), pasuar nga ato të mesme (93%). Sidoqoftë, edhe ndërmarrjet mikro (79%) kanë raportuar të kenë fituar klientë të rinj gjatë operimit të tyre.


Kompanitë e rajonit të Ferizajt kanë paraqitur një përqindje më të lartë të klientëve të rinj të fituar, pasuar nga bizneset e rajonit të Prizrenit dhe Gjilanit.

A keni fituar klientë të rinjë gjatë 2019?



Për rreth 48% të kompanive të anketuara në këtë studim të cilat kanë fituar klient të rinj në vitin 2018, klientela e re sillet midis 10% dhe 30% të total klientëve të tyre. Ndërsa janë vetëm rreth 11% e ndërmarrjeve tek të cilat klientët e rinj përbëjnë më shumë se 30% të klientelës së përgjithshme.

Nëse keni fituar klientë të rinj, sa është përqindja?




3/5 e kompanive të anketuara kanë rritur investimet në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017. Viti 2018 me gjithë vështirësitë duket të ketë qenë vit i favorshëm për bizneset në aspektin e investimeve.

Aktivitetet e investimeve që kryhen nga kompanitë janë të lidhura ngushtë me politikat e tyre të investimeve dhe të cilat mund të përcaktohen si një sistem i menaxhimit të proceseve optimale të investimeve. Ato politika mund të përfshijnë zbatimin e procesit të planifikimit operativ të investimeve të kompanisë dhe zhvillimin e projekteve të investimeve që përfshijnë përzgjedhjen dhe ekzekutimin e atyre më të mirave dhe më fitimprurëse duke siguruar që interesat ekonomike të kompanisë përmbushen në kontekstin e gjenerimit të të ardhurave dhe rritjen e performancës financiare të kompanisë, në përgjithësi.



Politika e investimeve është e kushtëzuar nga strategjia e zhvillimit që miratohet nga një kompani, në varësi të përafrimit të saj me objektivat afatshkurtra dhe afatgjata, aftësitë financiare dhe rikthimin në terma realë të kapitalit të përdorur/investuar, efektivitetin e projekteve investuese dhe rreziqet financiare dhe investuese që mund të kenë.


Zhvillimi i investimeve të bizneseve në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017



Bizneset e rajonit të Ferizajt kanë investuar më së shumti krahasuar me rajonet tjera (77%), pasuar nga bizneset e rajonit të Prizrenit (76%) dhe Prishtinës (65%). Asnjëra nga kompanitë e anketuara të rajonit të Pejës dhe Ferizajt nuk kanë deklaruar të kenë ulur investimet në vitin 2018.

Kompanitë e mëdha (91%) sërish kryesojnë sa i përket zhvillimit të investimeve të kompanisë në vitin 2018 në krahasim me vitin paraprak, pasuar nga kompanitë e mesme (72%). Nga ana tjetër janë rreth 11% e ndërmarrjeve mikro dhe 2% e ndërmarrjeve të vogla që kanë raportuar ulje të investimeve. Sërish, rritja e investimeve nga kompanitë e mëdha pritet të ketë një ndikim të madh në rritje ekonomike në vend.

Zhvillimi i investimeve të bizneseve në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017_sipas rajoneve (në %)



Rritja e investimeve nga kompanitë është thelbësore në mënyrë që të ketë rritje stabile ekonomike, të rritet punësimi, dhe të reduktohet varfëria në Kosovë.


Në aspektin sektorial, investimet janë rritur kryesisht në sektorin e prodhimit (74%) dhe atë të ndërtimit (71%). Nga ana tjetër janë rreth 6% të ndërmarrjeve shërbyese që kanë raportuar rënie të investimeve në vitin 2018 krahasuar me vitin paraprak.



4.1 Pritjet e bizneseve për zhvillimin e investimeve në vitin 2019


Pjesa e mëposhtme e këtij raporti i dedikohet planifikimeve të kompanive kosovare rreth investimeve në vitin 2019. Rreth 66 përqind e bizneseve kosovare presin të rrisin investimet në këtë vit krahasuar me vitin 2018. Investimi i sektorit privat është motori i rritjes ekonomike meqenëse rrit kapacitetin prodhues të ekonomisë, vendos bazën për të ardhura më të larta dhe krijon vende pune.

Pritjet mbi zhvillimin e investimeve të bizneseve në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018



Investimet më të mëdha në vitin 2019 pritet ti bëjë sektori i prodhimit (73.1%), pasuar nga tregtia me pakicë (68.3%) dhe ndërtimi (64.7%). Nga ana tjetër përqindje tejet simbolike e kompanive pjesëmarrëse në studim presin që investimet të zvogëlohen (3%). Tutje, janë rreth 6 përqind e ndërmarrjeve në sektorin e ndërtimit që presin që investimet të zvogëlohen në vitin 2019. Pavarësisht kësaj përqindje të ultë të pesimizimit për ulje të investimeve, megjithatë krahasuar me vitin paraprak vërehet një rritje e pritshmërive negative që sillet mes 4 dhe 6% -varësisht prej sektorit.

Pritjet mbi zhvillimin e investimeve të bizneseve në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018_sipas madhësisë së klasave (në %)



Edhe në këtë vit sikurse në vitet paraprake, ndërmarrjet mikro janë ato që kanë pritjet më të ulëta për investime në krahasim me kategoritë tjera.

Ndërsa asnjë prej kompanive të mëdha nuk parashikojnë që investimet në vitin 2019 të bien. Pra, pritjet që situata në vitin 2019 sa i përket investimeve të jetë mjaft premtuese dhe me gjasë do të jetë një stimul thelbësor në rritjen ekonomike të vendit.


Nën supozimin që këto investime do të ndodhin në këtë vit, atëherë rritja e investimeve do të nxiste rritjen më të lartë dhe më të qëndrueshme ekonomike dhe rritjen e produktivitetit si rezultat i investimit të kompanisë (në aspektin e kthimit të brendshëm dhe të jashtëm), kjo në situatë perfekte të funksionimit të ndërmarrjeve do të ndodhte përmes rritjes së shfrytëzimit të kapaciteteve, zhvillimit të aftësive për përdorim të teknologjisë, si dhe masave të tjera mbështetëse zhvillimore kombëtare.

Rritja e kompanive varet shumë nga shkalla e magnitudës dhe produktiviteti i investimeve të bëra. Rritja e investimeve kërkon mobilizimin e burimeve nga kursimet e brendshme dhe investimet e jashtme private të kompanisë. Kjo mbetet njëherit dyshimi më i madh për aftësinë e kompanive tona për të ndërmarrë investime të mëdha, duke dikur kufizimet e tyre financiare dhe në burimet njerëzore.



Për më tepër në kuadër të këtij studimi, kompanitë janë pyetur edhe për llojin e investimeve që planifikojnë të bëjnë gjatë vitit 2019. Kompanitë tona kryesisht kanë planifikuar të zëvendësojnë mjetet / makineritë e vjetra dhe të modernizojnë asetet ekzistuese (37%) që paraqet një rënie prej 7 p.p krahasuar me vitin paraprak. Një përqindje poashtu e lartë e kompanive (31%) të anketuara në këtë studim planifikojnë të zgjerojnë linjat e prodhimit / shërbimeve ekzistuese që njihërit paraqet rënie prej 12 p.p krahasuar me vitin 2018. Edhe në këtë vit, raporti i “fyteve të ngushta” nxjerr në pah rëndësinë minimale që i kushtohet aspektit të ndotjes dhe sigurisë në punë (1%).


Investimet e planifikuara për vitin 2019, do të jetë i këtij lloji



Një përqindje e vogël e ndërmarrjeve kosovare implementojnë sisteme të menaxhimit të cilësisë. Vetëm rreth 17% e ndërmarrjeve pjesëmarrëse në studim kanë deklaruar të jenë duke implementuar standardet EN ISO 9001. Megjithatë, kompanitë e anketuara në bazë të aftësisë/mundësisë që ato kanë për të zbatuar standardet janë të vetëdijshëm për rolin që standardet e cilësisë kanë në rritjen e konkurrencës, minimizimin e kostove, përmirësimin e procesit të punës, rritjen e mundësive për depërtim në tregjet e huaja dhe përmirësimin e reputacionit të kompanive. Një pjesë e madhe e kompanive mendojnë se sistemet e menaxhimit të cilësisë do të ndihmojnë në gjetjen e mundësive të reja për të eksploruar tregjet ndërkombëtare.

Ky është treguesi më i saktë për nevojën e madhe që kompanitë e Kosovës kanë në mbështetje të procesit të standardizimit. Në anën tjetër, një numër shumë i vogël i kompanive kanë deklaruar që nuk shohin interesim që në të ardhmën të implementojnë këto standarde, kjo për disa arsye: a) ato kompani që prodhojnë ose eksportojnë produktet e tyre si lëndë e parë / jo si produkt final nuk u kërkohet nga vendi importues që të kenë standarde të tilla, b) mungesa e mbështetjes financiare dhe shpenzimeve të larta që ka zbatimin e standardeve të tilla përmendet si njëra ndër ndër arsyet për mos implementim, c) mungesa e agjencive konsulente në nivel vendor për ofrim të shërbimeve të tilla, d) mbështetja jo e mjaftueshme e ekipit menaxhues në nivel ndërmarrje, e) mungesa e gatishmërisë së stafit profesional për të mbështetur zbatimin e standardeve. Duke marrë parasysh përbindjen e lartë të ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në Kosovë, të cilat përballen kryesisht me barrierat e ndryshme, ndër të cilat më i madhi është mungesa e qasjes në financa dhe mungesa e mjeteve financiare, rrjedhimisht zbatimin e standardeve në Kosovë do të vazhdojë të jetë një problem nëse nuk ka mbështetje nga mekanizmat shtetëror. Megjithatë, shkalla e lartë e kompanive që konfirmojnë rolin dhe rëndësinë e zbatimit të standardeve mbetet një sinjal premtues për të ardhmen.

Sisteme të menaxhimit të cilësisë



4.2 Informaliteti

Në vitin 2017, barriera kryesore e bizneseve në Kosovë ishte shkalla e lartë e informalitetit. Me qëllim identifikimin e faktoreve kryesorë që kanë ndikuar në këtë përqindje sipas opinionit të bizneseve, OEK-u në kuadër të studimit të *"fyteve të ngushta"* ka përfshirë një seksion të veçantë që i dedikohet kësaj teme.

Ekzistojnë përkufizime të ndryshme mbi informalitetin të cilat mund të kategorizohen në dy grupe kryesore, të cilat gjithashtu përcaktohen saktësisht nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO). Kategoria e parë thekson natyrën dualiste dhe të segmentuar të tregut të punës dhe përcakton "informalitetin" në aspektin e karakteristikave të ndërmarrjeve dhe kushteve të punës. Kategoria e dytë i referohet statusit ligjor të veprimtarisë ekonomike. Një aktivitet ekonomik përkufizohet si "joformal" nëse është i ligjshëm por nuk regjistrohet ligjërisht. Matja e informalitetit është një instrument që mund të shërbejë për të analizuar burimet e rritjes së BPB-së dhe ndjeshmërinë relative të sektorit joformal në politikat ekonomike. Ky objektivi është theksuar në Sistemin e Llogarive Kombëtare të 1993 (System of National Accounts-SNA), i cili thotë se për qëllime të analizës ekonomike dhe hartimit të politikave "është veçanërisht e rëndësishme për shumë vende në zhvillim që të jenë në gjendje të bëjnë dallimin midis sektorëve formalë dhe joformalë të ekonomisë "(UN et al., 1993, paragrafi 4.159)^{viii}.

Aktivitetet tipike të sektorit informal (puna e papaguar në një ndërmarrje familjare, puna me rroga të rastësishme, puna në shtëpi, shitjet në rrugë) ofrojnë mundësi të vetme për shumë njerëz të varfër për të siguruar nevojat e tyre bazë për mbijetesë. Në vendet pa sigurim gjatë papunësimit ose lloje të tjera të përfitimeve sociale, alternativa e vetme është angazhimi në punësimin e sektorit informal. Forma tjetër e informalitetit është punësimi informal (si punëdhënës në ndërmarrjet prodhuese joformale ose si punëtorë të vetëpunësuar të kualifikuar në bizneset e vogla) që ndonjëherë mund të ofrojnë paga më të mira. Këta punëtorë mund të fitojnë edhe më shumë se punëtorët e rregullt që punojnë në punë formale. Por edhe për këta punëtorë të mirë dhe të kualifikuar, punësimi në sektorin informal në vend të punësimit në sektorin formal është shpesh alternativa e vetme. (Chen et al, 2005, f. 47-49).

Megjithatë, shumë studime shpeshherë kanë gjetur korrelacion mes shkallës të madhësisë së kompanive dhe informalitetit. Kjo kryesisht për shkak të disa faktorëve: a) Ndërmarrjet e vogla mund të mbeten të paidentifikuara nga autoritetet më lehtë sesa ndërmarrjet më të

mëdha; b) qeveritë me burime të kufizuara administrative kanë tendencë të përqëndrohen në ndërmarrjet e mëdha kur mbledhin taksat ose kur zbatojnë legjislacionin e punës; c) Sindikatat priren të përqëndrohen në ndërmarrjet e mëdha, të cilat mund të arrihen më lehtë, në mënyrë që përpjekjet e tyre të kenë ndikim maksimal; dhe d) ndërmarrjet e vogla tentojnë të përdorin metoda më tradicionale të prodhimit. Madje, disa nga studimet, vënë në theks që mos regjistrimi i bizneseve, përderisa nuk është i bashkëlidhur me ndonjë veprim tjetër nuk është e drejtë të llogaritet si informalitet. Në Kosovë jo formalizimi i ndërmarrjeve ka luajtur rolin kryesor në përcaktimin e informalitetit të kompanive. Në këtë seksion bizneset janë pyetur për shumë nga dukuritë që konsiderohen si determinantë të (jo)informalitetit.

Informaliteti paraqet probleme serioze ekonomike, sociale dhe politike për një ekonomi. Një ekonomi e madhe joformale pengon pothuajse të gjitha përpjekjet e qeverive për të mbledhur të ardhura të mjaftueshme tatimore, duke dëmtuar kështu në masë të madhe ofrimin efikas të mallrave dhe shërbimeve publike dhe gjithashtu duke ulur produktivitetin e përgjithshëm dhe rrjedhimisht duke ulur edhe potencialin e rritjes së ekonomisë.

Rreth 48 përqind e kompanive pjesëmarrëse në studim kanë deklaruar që pavarësisht rrethanave ato arrijnë t'u konkurrojnë ndërmarrjeve informale.


Kostoja financiare e kompanive formale shtohet me këtë rast. Megjithatë, në pikëpamjen e de Soto (1989)^{ix}, shpenzimet për t'u bërë kompani formale janë shumë të larta dhe kompanitë janë përjashtuar në mënyrë efektive nga sfera formale dhe janë detyruar të mbeten nën nivelin optimal.

Informaliteti në Kosovë, megjithëse jo më i lartë se në vendet e rajonit dhe në ekonominë në tranzicion, është ende një burim shqetësues për politikëbërësit kosovar, kjo kryesisht pasi që reflekton një gjendje ekonomike jo të favorshme dhe mungesë të mekanizmave qeveritarë për të luftuar dhe mbajtur nën kontrollë atë. Tutje, ajo për të dyja sektorët (privat dhe publik) pasqyron kushte më pak të favorshme pune, produktivitet më të ulët për ndërmarrjet dhe veçanërisht zbatim të dobët të sundimit të rendit dhe të ligjit, e cila është ndër pengesat më të theksuara në vendin tonë.




Studimi nxjerr në pah mungesën e zhvillimit dhe rritjes adekuate të kompanive dhe kostot e larta të operimit si ndër arsyt kryesore përse kompanitë vendosin të jenë në sektorin joformal.

Ju si kompani a konkurroni kundër firmave të paregjistruara ose joformale?



Shkalla e lartë e konkurrencës jolojale në vend ka dëmtuar shumë bizneset me veprimtari të rregullt biznesore. Mbi 39 përqind e kompanive pjesëmarrëse në studim kanë thënë se forma e veprimtarisë së konkurrentëve që veprojnë në sektorin joformal është pengesë madhore. Vetëm rreth 14 përqind e tyre kanë deklaruar të mos kenë ndonjë ndikim nga veprimtaria e konkurrentëve joformal.

A mendoni që praktikat e konkurrentëve në sektorin informal janë pengesë kryesore?




Janë vetëm rreth 36 përqind e ndërmarrjeve të anketuara në këtë studim që mendojnë që kompanitë regjistrohen formalisht në momentin e aktivizimit të veprimtarisë biznesore. Sidoqoftë është tejet e vështirë të pasqyrohet saktë efekti i mosregjitrimit të bizneseve që nga fillimi i veprimtarisë.

Matja e ekonomisë joformale në këto raste është tejet e vështirë. Kjo, pasi që pjesa më e madhe e informalitetit në këto kushte ndodh në sektorin e bujqësisë, duke përfshirë bujqësinë e ekzistencës dhe shitjet jozyrtare të kulturave të tregtueshme. Një pjesë poashtu e madhe, të paktën në aspektin e punësimit, vjen nga tregtarët dhe shitësit e vetëpunësuar që jetojnë në kushte të përfaqëta (Banerjee dhe Duflo 2011)^x.

Rreth gjysma e kompanive të sektorit të tregtisë me pakicë mendojnë që kompanitë nuk regjistrohen formalisht që nga fillimi, pasuar nga sektori i shërbimeve (21%). Duke matur përceptimin e tyre ne mund të supozojmë që këta dy sektorë përballen me vështirësi të kësaj natyre në shkallë më të lartë krahasuar me sektorët tjerë.




A mendoni që kompanitë kosovare regjistrohen formalisht posa fillojnë veprimtarinë biznesore?



Në drejtim të identifikimit të periudhës së mos formalizimit të bizeseve, pjesa më e madhe e kompanive, mendojnë që kjo ndodh vetëm disa muaj (43%), ndërsa rreth 28 përqind e kompanive janë të mendimit që kompanitë veprojnë pa regjistrim zyrtar deri në një vit. Nga përqindja e kompanive që mendojnë që bizneset nuk regjistrohen formalisht deri në një vit, 53% e kësaj përqindje janë kompani të tregtisë me pakicë, ndërsa rreth 19 përqind janë kompani prodhuese.


Sa mendoni që është numri i viteve të veprimtarisë së kompanive pa regjistrim zyrtar?



Për më tepër duke synuar të masim informalitetin në punësim, ne kemi kërkuar opinionin e bizneseve nëse konkurrentët e tyre deklarojnë të gjithë punëtorët. Nga gjithsejt përqindja e të anketuarve, afërsisht gjysma e tyre mendojnë që kompanitë nuk deklarojnë të gjithë punëtorët. Janë vetëm rreth 11 përqind që mendojnë që kompanitë deklarojnë numrin e saktë të punëtorëve të tyre. Shikuar nga dimensionet sektoriale, nga përqindja e kompanive që mendojnë që konkurrentët nuk deklarojnë punëtorët, 35% janë kompani të shitjes me pakicë, ndërsa 27% janë kompani prodhuese.




A mendoni që konkurrentët tuaj deklarojnë të gjithë punëtorët?



Janë vetëm rreth 10% e kompanive që mendojnë që konkurrentët deklarojnë me rregull tatimet dhe kontributet tek institucionet relevante. Nga ana tjetër rreth 47 përqind e ndërmarrjeve të anketuar mendojnë që konkurrentët nuk janë të rregullt në deklarim të tatimeve dhe kontributeve.


A mendoni që konkurrentët tuaj deklarojnë tatimet dhe kontributet me rregull?



Tutje, vetëm 12 përqind e ndërmarrjeve pjesëmarrëse në këtë studim mendojnë që konkurrentët e tyre paguajnë me kohë dhe në mënyrë të rregullt taksat. Nga pikëpamja sektoriale rreth 33% e kompanive të tregtisë me pakicë theksuan që konkurrentët e tyre nuk paguajnë detyrimet tatimore me rregull, pasuar nga sektori i prodhimit (28%).

Nga përqindja e kompanive që kanë deklaruar që konkurrentët e tyre nuk paguajnë me rregull obligimet tatimore, 45% e tyre janë ndërmarrje të vogla, ndërsa 22% ndërmarrje të mesme.

A mendoni që konkurrentët tuaj paguajnë taksat me rregull?




Qëllimi kryesor i secilës kompani është maksimizimi i fitimit. Nëse kompanitë përballen me probleme në këtë kontekst, në këto rrethana supozohet të zërë vend informaliteti. Rreth 48% e kompanive dëshmojnë që ndër arsyt kryesore për shkallën e lartë në sektorin joformal të jetë fitimi i ultë (48%), pasuar nga taksat e larta (30%), aktiviteti i ultë ekonomik (9%) dhe aftësia e ultë konkurruese e ndërmarrjeve tona (8%).

Firmat formale dhe joformale bashkëveprojnë në të njëjtin treg. Produktet që ofrohen në sektorin informal konsiderohen si zëvendësues i përsosur për atë të sektorit formal. Prodhuesi joformal shet në bruto të çmimit tatimor, i cili jepet nga funksioni i kërkesës së anasjelltë, respektivisht si prodhim i industrisë. Firmat në sektorin formal paguajnë taksat për mallrat; të ardhurat tatimore të mbledhura përdoren për të financuar një aktivitet




qeveritar, i cili, supozohet, që nuk ndikon në produktivitetin e sektorit formal. Firmat në sektorin informal nuk paguajnë asnjë taksë, por përballen me një kosto informale e cila nuk është e lidhur me procesin e prodhimit. Për shembull, ata ndërmarrin ndonjë aktivitet të kushtueshëm për të shmangur identifikimin nga organet shtetërore që luftojnë informalitetin ose zbatimin e kontratave dhe për të parandaluar vjedhjet dhe vandalizmin, pasi që ato janë të privuara nga shumica e shërbimeve që zbatohen në sektorin formal. Si konkluzion, informaliteti ka kosto edhe për kompanitë që i përkasin këtij sektori.

Cfarë mendoni që ndikon në pjesëmarrjen e vogël të kompanive në sektorin formal?



Sipas kompanive, sistemi i taksave ka ndikuar mesatarisht në shkallën e informalitetit (45%). Për rreth 16% të kompanive ndikimi i sistemit të taksave ka qenë shumë i madh në rritje të informalitetit.

A mendoni që sistemi i taksave ka ndikuar në shkallën e informalitetit?




Sa i takon formës më të shprehur të informalitetit, sipas kompanive, konkurrentët e tyre kryesisht nuk deklarojnë punëtorët (55%), pasuar nga mos pagesa e tatimeve dhe taksave (25%) dhe rrugët jo të sigurta prej nga vijnë mallrat dhe shërbimet e konkurrentëve (15%).

Kriteri i mos deklarimit të punonëtorëve të kompanisë reflekton realitetin se kushtet e punësimit në sektorin informal janë ndryshe nga ato që konsiderohen normale në sektorin formal. Ky dallim ka formën e mungesës së kontratave të punës ose benefiteve të profesionit, kushte elementare që i detyrojnë punëdhënësit të paguajnë taksat përkatëse dhe kontributet e sigurimeve shoqërore në emër të punëtorëve ose që e bëjnë marrëdhënien e punës t'i nënshtrohet legjislacionit të punës, respektivisht ligjeve në fuqi. Sipas këtij kriteri, Organizata Ndërkombëtare e Punës, konsideron që një ndërmarrje është informale nëse asnjë nga punëtorët e saj nuk është i regjistruar në autoritetet përkatëse për qëllime tatimore ose të sigurimeve shoqërore. Kriteri është veçanërisht i dobishëm në vendet ku regjistrimi i punëtorëve nënkupton regjistrimin e ndërmarrjeve në institucionet e sigurimeve shoqërore (në rastin tonë tek trusti pensional).



Cilën prej opsioneve të mëposhtme mendoni që kompanitë në Kosovë e aplikojnë më shumë?




92% e bizneseve të rajonit të Ferizajt, mendojnë që kompanitë vendore nuk deklarojnë punëtorët e tyre. Ndryshe është perceptimi për bizneset e Gjilanit, ku rreth 61% e tyre mendojnë që binzeset nuk paguajnë taksat.

Për rreth 29 përqind të ndërmarrjeve të rajonit të Mitrovicës të intervistuar, kompanitë përdorin rrugë joligjore dhe informale për të sjellë produktin/shërbimin e tyre në treg, duke minimizuar kështu fuqinë e tyre biznesore dhe duke ulur aftësinë konkurruese të bizneseve formale.

Perceptimi i komunitetit të biznesit mbi shkallën e informalitetit në Kosovë është shumë i lartë. Sipas 33% të ndërmarrjeve të anketura në studim, informaliteti në vendin tonë sillet mes 30%-50%. Përqindja më e lartë e kompanive që mendojnë që shkalla e informalitetit sillet mes 30-50% janë kompani të vogla (40%).

Për më tepër rreth 9 përqind e të anketuarve, mendojnë që informaliteti është më i lartë se 50% në kompanitë e Kosovës. Përqindjen më të madhe të këtyre kompanive e përbëjnë kompanitë e vogla dhe të mesme.

Sa mendoni që është shkalla e informalitetit në vendin tonë?




18% e respondentëve nga rajoni i Gjilanit thanë se informaliteti është më i lartë se 50% në këtë rajon, pasur nga rajoni i Pejës ku respondentët thanë se informaliteti është rreth 13%.

Pjesa më e madhe e kompanive, respektivisht mbi 57% e tyre mendojnë që informalitetin në vend duhet ta luftojë qeveria përmes institucioneve dhe mekanizmave të saj. Nga ana tjetër një përqindje goxha e lartë, respektivisht rreth 41% e kompanive mendojnë që informaliteti duhet të luftohet bashkërisht, si nga qeveria ashtu edhe në sektori privat.



Kush mendoni që duhet të luftojë informalitetin në vendin tonë?




Afërsisht 80% e kompanive të anketuara deklaruan që informaliteti duhet të luftohet qoftë drejtëpërdrejt nga Ministria e Financave (44%) ose përmes agjencioneve që janë nën vartësinë e saj, respektivisht Dogana e Kosovës (20%) dhe Administrata Tatimore e Kosovës (15%).

Pjesën më të madhe të kompanive që mendojnë që informaliteti duhet të luftohet nga Ministria e Financave e përbëjnë kompanitë e vogla (49%).

Një përqindje prej rreth 20% e kompanive pjesëmarrëse në anketim, mendojnë që informaliteti duhet të luftohet ekskluzivisht nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përmes inspektorateve që janë nën kompetencë të saj.



Nëse informalitetin duhet ta luftojë qeveria, ju lutem na tregoni cili institucion?






5. BARRIERAT E PËRGJITHSHME DHE SFIDAT

Oda Ekonomike e Kosovës duke pasur për qëllim identifikimin dhe evidentimin e problemeve me të cilat kompanitë u ballafaquan e që ishin shumë të përfolura gjatë vitit 2018, kryesisht në mungesën e fuqisë punëtore të shkathtë dhe ndërlidhja mes faktorëve tjerë që ndikojnë në këtë gjendje ka analizuar ndikimin e tyre tek kompanitë. Fuqia punëtore e shkathtë është padyshim çelësi i suksesit për çdo kompani në ditët e sotme, veçanërisht për sektorin prodhues dhe atë tregtar. Në fakt, mungesa e fuqisë punëtore të shkathtë është një prej problemeve primare me të cilat përballet komuniteti i biznesit.

Vështirësitë në rekrutim të stafit nuk janë si rezultat i mungesës së punëtorëve, por për shkak të mungesës së njohurive të tyre për procesin e punës nëpër kompani. Nga ana tjetër, kompanitë, të ndodhura në rrethana financiare jo të favorshme, veçanërisht sa i takon mundësisë për të investuar në aftësim të mëtejshëm të punëtorëve, nuk kanë pasur ndonjë mundësi të madhe të ndikojnë për të përmirësuar këtë gjendje. Për të konkurruar në mënyrë efektive në tregjet vendore dhe ndërkombëtare, prodhuesit duhet të vazhdojnë të gjejnë mënyra për të shtuar vlerën dhe për t'u përgjigjur më shpejt ndryshimit të kërkesave të konsumatorëve, në këtë proces veçanërisht ndihmon fuqia punëtore e shkathtë.


Sa ishte e vështirë rekrutimi i stafit të ri gjatë vitit 2018?



Sipas 13 përqind të kompanive të anketuara rekrutimi i stafit të ri gjatë 2018 ishte shumë i vështirë. Nga ana tjetër rreth 29% e tyre deklaruan që rekrutimi ishte i lehtë dhe kanë arritur të gjejnë staf adekuat për të përmbushur nevojat e kompanisë.

Nga përqindja e kompanive që kanë deklaruar që e kanë pasur problem gjetjen e punëtorëve të rinj, vështirësitë më të mëdha i kanë pasur ndërmarrjet e vogla (39%) pasuar nga ato mikro (32%).

Sa ishte e vështirë rekrutimi i stafit të ri gjatë vitit 2018? Sipas madhësisë së kompanisë (në %)



Migrimi është një fenomen që ndikon në formimin dhe grumbullimin e kapitalit njerëzor, veçanërisht në migrimin e fuqisë punëtore të kualifikuar nga vendet e varfëra tek ato të zhvilluara. Migrimi ndikon në procesin e krijimit të kapitalit njerëzor kryesisht tek "rrjedhja e trurit" që ka një efekt negativ dhe varet nga pjesa e "trurit" e totalit të migrantëve; në vendin tonë mund të flasim për një "ikje optimale të trurit", e cila manifestohet kur arsimi shihet si një "pasaportë" drejt emigracionit; kështu, mundësia e emigrimit stimulon studentët nga vendi burimor, të ndjekë studimet akademike. Prandaj, ikja e trurit mund të konsiderohet si një strategji e cila ndjek edukimin dhe "eksporton" punëtorë të kualifikuar në mënyrë që të tërheqë përfitime ekonomike. (Connell J, Kitanai, 1993)^{xi}.




Migrimi në shumë raporte paraqitet me ndikim të dyanshëm. Përderisa, migrimi ka efekt negativ te kompanitë duke ndikuar kështu procesin e punës, migrimi shihet edhe si mundësi për kompanitë kur individët kthehen në vendin e origjinës me njohuri të reja në fusha të caktuara, veçanërisht në transformimin e njohurive të fituara.

Rreth 29 përqind e kompanive kanë thënë që janë ndikuar nga largimi i punëtorëve nga vendi, duke krijuar vështirësi të mëdha në përshtatje të vendeve të punës dhe gjetjen e punëtorëve të rinjë.

39% e kompanive prodhuese të përfshira në studim kanë deklaruar që janë ndikuar negativisht nga migrimi i stafit, pasuar nga sektori i ndërtimit (35%) dhe ai i tregtisë me shumicë (32%).

Shikuar nga dimensionimi rajonal, kompanitë e rajonit të Ferizajt duket të jenë ndikuar më së shumti nga migrimi i punëtorëve (62%), pasuar nga rajoni i Mitrovicës (44%) dhe ai i Gjakovës (33%).

A është ndikuar kompania juaj nga migrimi i fuqisë punëtore?



■ Po ■ Jo ■ Pjesërisht


Pjesa dërmuese e kompanive pjesëmarrëse në studim kanë thënë që planifikojnë të rrisin numrin e punëtorëve në vitin 2019, duke dhënë kështu sinjale të qarta për aktivitet të shtuar biznesor dhe rritje të mirëqenies në Kosovë. Rritja e punësimit ka efekt zingjiror pozitiv, me çfarë mund të parashikohet edhe një stabilitet social dhe rritje ekonomike.

87% e kompanive ndërtimore të përfshira në këtë hulumtim kanë deklaruar që do të rrisin numrin e punëtorëve në vitin 2019, pasuar nga sektori i prodhimit (83%) dhe sektori i tregtisë me shumicë (65%).

Shumica e ndërmarrjeve të anketuara kanë pritje pozitive për punësim, përveç ndërmarrjeve mikro (35%) ku pritjet për rritje të punësimit janë më të ulta krahasuar me kategoritë e tjera të kompanive.

Shikuar nga dimensionimi i madhësisë së kompanive, rreth 91% e kompanive të mëdha në Kosovë presin të rrisin numrin e punëtorëve në 2019, pasuar nga kompanitë e mesme (81%).

A do të punësoni punëtorë të rinj gjatë vitit 2019?




Tutje, rreth 80% e ndërmarrjeve të rajonit të Mitrovicës presin që të rrisin numrin e punëtorëve. Për dallim prej vitit paraprak kur rajoni i Ferizajt printe dukshëm me pritjet më të larta për punësim, në këtë vit sado që pritjet janë të larta (60%), krahasuar me rajonet e tjera vërehet një lëvizje e lehtë në rënie.




Nga përqindja e kompanive që kanë deklaruar që do të rrisin numrin e punëtorëve, rreth 58% e tyre besojnë që kjo rritje do të jetë mes 1 dhe 3 punëtorë. Rreth 12 përqind e kompanive presin që numri i punëtorëve të rritet mes 5-10 punëtorë të rinjë.

Nëse "Po" sa punëtorë do të punësoni?



Kompanitë e mëdha të sektorit ndërtimorë kanë pritshmëri më të larta për rritje të numrit të të punësuarve në më shumë se 10 punëtorë të rinjë. Nga ana tjetër rreth 78% e kompanive të shitjes me pakicë pjesëmarrëse në këtë hulumtim presin që të punësojnë në mes 1 dhe 3 punëtorë. Tutje, rreth 20 përqind e ndërmarrjeve prodhuese presin që të punësojnë mes 5 dhe 10 punëtorë gjati vitit 2019.

Sa është numri i punëtorëve që do të punësohen gjatë 2019? Sipas sektorëve (në %)



6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

1. *Avancimi i partneritetit me bankat komerciale në Kosovë* nën monitorim të Bankës Qëndrore të Kosovës për lejimin e mundësive për kamata fleksibile në interes të sektorit privat. Një treg financiar i zhvilluar siç është rasti i Kosovës mund të ndikojë dhe nxisë rritjen ekonomike afatgjatë element ky që lidhet me efikasitetin me të cilin bizneset përdorin kapitalin. Në ekonomitë në zhvillim duket se normat e interesit janë shumë të paqëndrueshme dhe lidhen ngushtë me bilancin tregtar. Mungesa e parasë së gatshme në vend dhe nga ana tjetër pamundësia e sektorit privat për qasje në burimet e financimit ndikon në aktivitetet biznesor të ultë dhe shkallë të ultë të aktivitetit ekonomik. Një politikë favorizuese duke mundësuar kamata fleksibile për kompanitë prodhuese dhe veçanërisht për start-up do të krijonte kushte tejet të favorshme.
2. *Forcimi i sundimit të rendit dhe ligjit* - Komuniteti i biznesit në Kosovë vazhdon të raportojë problemet që lidhen me sundimin e rendit dhe ligjit. Kjo kryesisht lidhet me mos efikasitetin e gjyqësorit kosovar. Vonesat e proceseve gjyqësore të cila marrin edhe vite për t'u zgjidhur kanë bërë që bizneset të humbin besimin në gjykata. Madje edhe kur vendimi kthehet në favor të bizneseve, pas një periudhe kaq të gjatë të pritjes, nuk ka asnjë dobi për shkak të dëmit që një vonesë e tillë ka pasur duke ulur aftësinë konkurruese, dëmtuar imazhin e kompanisë dhe më e ndjeshmja duke zvogëluar qarkullimin e parasë për kompaninë dhe rrjedhimisht duke ulur aktivitetin biznesor të tyre. Oda Ekonomike e Kosovës, në përputhje me nevojat e biznesit brenda gamës së shërbimeve të saj, ka tribunalin e arbitrazhit, qëllimi i së cilit është zgjidhja e problemeve të biznesit dhe mosmarrëveshjeve biznesore brenda dhe jashtë vendit. OEK beson se kriza ligjore ka më shumë ndikim mbi ndërmarrjet sesa kriza ekonomike. Nevojitet një riorganizim i plotë për të reformuar legjislacionin aktual sipas rrethanave në Kosovë.
3. *Mbështetje për aftësim profesional dhe edukim gjatë gjithë jetës*- OEK-u në vazhdimësi ka ngritur zërin për nevojën dhe harmonizimin e planprogrameve arsimore në përputhje me nevojat e sektorit privat. Theks të veçantë OEK-u i jep arsimin dual, ku nga Qeveria dhe Parlamenti i Republikës të Kosovës kërkohet të miratojnë një pako ligjore që mundëson zbatimin e sistemit të "Arsimit Dual", sipas modelit të vendeve

gjermano-folëse i cili duhet domosdoshmërisht të përshtatet me specifikat vendore. Hulumtimi i OEK-ut në muajin shkurt 2019 mbi “Vlerësimin e potencialeve për eksport”, tregon qartë që ndërmarrjet që nuk e shfrytëzojnë potencialin për eksport një ndër barrierat kryesore e kanë mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar. Kurrikulat ekzistuese në Kosovë nuk janë as për së afërmi të harmonizuara me nevojat aktuale të tregut të punës, e aq më pak me trendet globale të projektuara për të ardhmën. Për zbatim të sistemit të “Arsimit Dual”, përveç nevojës për kurrikula të reja, standarde profesionale të reja, kërkohet edhe buxhet i vecantë, prandaj OEK-u i rekomandon qeverisë që në buxhetin që do të planifikohet për vitet në vijim, financimi i zbatimit të sistemit të “Arsimit Dual” të jetë ndër prioritet kryesore.

4. *Kostoja e energjisë elektrike*- Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese/ termocentrali Kosova e Re duke shfrytëzuar resurset natyrore që i kemi (rezervat e linjitet), është domosdoshmëri, mirëpo transformimi global i politikave për energjinë, nënkupton edhe rritje të investimeve publike dhe private në efikasitet, burime të ripërtitshme dhe komplementaritet me vendet e rajonit, në kuadër të një tregu rajonal për energjinë. Në krejt këto rrethana, kur kemi shumë paqartësi rreth të ardhmes së sektorit energjetik në Kosovë, sektori privat vazhdimisht paguan kosto të papërbalueshme të lidhura me mungesën e furnizimit të rregullt dhe stabil me energji elektrike. Kjo vazhdon për 19 vite me rradhë.

Rekomandohet:

- a) Rritja e fondit për efikasitet, me mundësi përfitimi për të gjitha bizneset (MZHE);
- b) Përfundimi i tregut të përbashkët të energjisë me Shqipërinë (KOSTT dhe qeveria);
- c) Rritja e fondit për përkrahje të instalimeve të paneleve solare dhe pajisjeve tjera që mundësojnë gjenerim të energjisë nga burime të ripërtitshme, në bizneset prodhuese (Minsitritë e ndryshme)
- d) Subvencionimi i një pjesë të faturave të energjisë elektrike për prodhimet që eksportohen (Ministritë e ndryshme);
- e) Përkrahje financiare për start-up dhe biznese të vogla për kyçje në rrjet (MZHE dhe MTI);
- f) Ndryshimi i modelit tarifor duke kufizuar ndërsbvencionimin në mes kategorive të ndryshme të konsumatorëve, dhe rritja e konkurrencës në furnizim (ZRRE);
- g) Trajtimi i “ngarkesës në kapacitet” (maksigrafit), në bazë të praktikave rajonale dhe të vendeve të BE-së (ZRRE).

5. *Rritja e bashkëpunimit me institucionet në vend, me theks të veçantë me ATK-në* duke vënë theks të veçantë tek informimi mbi ndryshimet e legjislacionit, rregulloreve dhe veçanërisht ndëshkimeve të këtij institucioni për bizneset. Është përmendur edhe mungesa e aftësive të komunikimit të zyrtarëve të ATK-së si një barrierë për bizneset, andaj rekomandimi adresohet në ngritjen e pregtitjes profesionale të stafit të ATK-së, veçanërisht zyrtarët dhe inspektorët tatimor.
6. *Minimizimi i efektit politik në aktivitetin biznesor-* në shumë raporte të publikuara nga OEK-u është raportuar që në periudhat kur vendi ka jo-qëndrueshmëri politike, performanca e biznesit në Kosovë bie dukshëm. Rrjedhimisht, efekti politik paraqitet të ketë efekt negativ tek bizneset, andaj duhet të ndërmerren masat adekuate që nëse është e pamundur evitimi i plotë i këtij efekti, së paku të mos jetë në shkallë kaq të lartë.
7. *Luftimi i informalitetit-* shkalla e lartë e informalitetit në vend mbetet një prej sfidave kryesore të bizneseve dhe jo vetëm, lirshëm mund të kategorizohet edhe si sfida e dekadës së pavarësisë për ndërmarrësit kosovar, veçanërisht ato kompani që operojnë në tregun formal dhe janë taksapagues të rregullt. Dëmtimi më i madh i bëhet sektorit prodhues me potencial për të rritur eksportin, duke theksuar se një kalim në ekonominë formale është kusht për të realizuar punë të denjë për të gjithë. Shqetësimet e sektorit privat vendor po rriten, dhe kjo është më e theksuar nga informaliteti në rritje në veri të vendit. Siç është raportuar edhe në vitet e kaluara, OEK ngreh shqetësime në lidhje me mosfunksionimin e mekanizmave shtetërorë për të mbajtur kontrollin e informalitetit që ka dëmtuar në masë të madhe aftësinë konkurruese dhe zhvillimin e potencialeve të ndërmarrjeve. Punësimi informal këtë vit paraqitet si pengesë në rritje që po dëmton rëndë konkurrueshmërinë e sektorit privat.

7. METODOLOGJIA

Pengesat e rritjes për bizneset në Kosovë janë analizuar në këtë raport me ndihmën e një ankete me biznese të realizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës. Anketa përdor një pyetësor, i cili në veçanti u zhvillua dhe modifikua për gjendjen ekonomike në vend.

Pyetësi me pyetje specifike është zhvilluar nga stafi i OEK-ut, respektivisht nga departamenti i analizave ekonomike dhe politikave. Pyetësi përbëhet nga katër pjesë: Pjesa e parë shqyrton disa karakteristika të firmës. Pjesa e dytë fokusohet në vlerësimet e situatës ekonomike të firmës në lidhje me shitjet dhe investimet. Pjesa e tretë përmban pyetje lidhur me pengesat për veprimtarinë e firmave. Pengesat janë klasifikuar në tri kategori të pengesave të jashtme: mjedisi ekonomik, kushtet administrative dhe rregullatore, si dhe infrastruktura dhe kushtet e përgjithshme. Përveç faktorëve të jashtëm, janë përfshirë gjithashtu pyetje për pengesat e brendshme.

Në fund të pyetësit ne kemi shtuar një seksion të veçantë në lidhje me barrierat e biznesit në fusha më të gjera.

Karakteret e anketës është edhe cilësore edhe sasore. Pra, të anketuarit janë pyetur për të dhënë përgjigje në bazë kualitative verbale, po ashtu u është kërkuar të japin rekomandimet e tyre në fusha të caktuara. Opsionet për përgjigje janë për shembull: asnjë pengesë / pengesë e moderuar / pengesë e madhe ose nuk zbatohet.

Madhësia dhe struktura e mostrës plotëson kriteret statistikore për të fituar rezultate përfaqësuese. Të dhënat janë mbledhur nga intervistat personale. Stafi i OEK-ut vizitoi bizneset në mes të 3 dhe 21 dhjetor 2018. Bizneset e vizituara janë përzgjedhur nga baza e të dhënave e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK).

Hulumtimi pasqyronë situatën e biznesit në vitin 2018.

8. Referenca

ⁱ Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, TM3 2018 <http://ask.rks-gov.net/media/4387/repertori-statistikor-mbi-nd%C3%ABrmarjet-ekonomike-n%C3%AB-kosov%C3%AB-tm3-2018.pdf>

ⁱⁱ <http://ask.rks-gov.net/media/4500/bruto-produkti-vendor-tm3-2018.pdf>

ⁱⁱⁱ <http://ask.rks-gov.net/media/4473/anketa-e-fuqis%C3%AB-pun%C3%ABtore-afp-tm3-2018.pdf>

^{iv} Alauddin, M and Chowdhury, M (2015). Small and Medium Enterprises in Bangladesh Prospects and Challenges, Global Journal of Management and Business Research

^v Blocker, Christopher P., Joseph P. Cannon, Nikolaos G. Panagopoulos, and Jeffrey K. Sager (2012), "The Role of the Sales Force in Value Creation and Appropriation: New Directions for Research," Journal of Personal Selling & Sales Management, 32(1), 15-27.

^{vi} Davis, S. J., J. Haltiwanger, and S. Schuh. (1993). "Small Business and Job Creation: Dissecting the Myth and Reassessing the Facts," Business Economics 29, 13–21;

^{vii} Biggs, T., R. Vijaya, and M. Shah. (1998). "The Determinants of Enterprise Growth in Sub-Saharan Africa: Evidence from the Regional Program on Enterprise Development," World Bank. RPED Discussion Paper 103.

^{viii} 1993. "Resolution concerning statistics of employment in the informal sector, adopted by the Fifteenth International Conference of Labour Statisticians", in Fifteenth International Conference of Labour Statisticians (Geneva, 19-28 January 1993), Report of the Conference (Geneva, ILO).

^{ix} de Soto, H. 1989. The Other Path. New York: Basic Books.

^x Banerjee, Abhijit V., and Esther Duflo. 2011. Poor Economics: A Radical Rethinking of the Way to Fight Global Poverty. New York: Public Affairs, Perseus Books

^{xi} Connell J, Kitanai, (1993), Kitsui and Kiken: The Rise of Labour Migration to Japan, Economic & Regional Restructuring Research Unit, University of Sydney



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Rr. Nënë Tereza Nr.20
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel & Fax: +383 (0) 38 224 299
info@oek-kcc.org, www.oek-kcc.org